



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
TIRANË**

Tiranë, me 22.10.2024

NJOFTIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONKURIMIT
PËR**

**EMERIMIN NË POZICIONIN E PUNËS NJË VEND PËR
SPECIALIST –FINANCE**

Bazuar në Ligjin Nr 97/2016 “ Për Organizimin dhe funksionimi e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë , si dhe mbi bazën e “ Strukturës organike të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me qëllim plotësimin e vendeve vakant në zbatim të strukturese Institucionit, në përmbushje të organikës Nr. 19 datë 30.01.2024 të Prokurorit të Përgjithshëm për Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

- Kërkohe të punësohet një punonjës/e me emertese Specialist-Finance, në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me adrese ,Rr. Haxhi.H. Dalliu Nr 97 Tiranë..

NJOFTON

-Fillimin e Procedurës së konkurimit të hapur të kandidateve për një pozicion me emertese Specialist-Finance , në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë .

-Referuar neneve 74,75,76 të Ligjit nr 97/2016 “ Për Organizimin dhe Funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë “, kandidatet e interesuar për konkurim, përveç kushteve të përgjithshme për tu pranuar në punë, duhet të plotësojnë dhe kriteret të veçanta.

- Kandidatët për një pozicion të lirë të punës Specialist –Finance duhet të paraqesin kërkesën së bashku me dokumentacionin e meposthëm :

Kërkesat e Përgjithshme:

1. Të jetë shtetas Shqiptar
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar
3. Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
5. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtje penale me dashje si dhe të mos jetë nën hetim
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil apo administrata shtetërore që nuk është shuar sipas këtij ligji

Kërkesat e veçanta- prioritet në përzgjedhjen e kandidatëve

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në shkenca ekonomike , Diplomë “MasterShkencor ose Profesional”. Nëse i përket sistemit Bachelor, diploma duhet të jetë në shkenca ekonomike.
2. Të ketë përvojë profesionale jo më pak se 1 (një) vjet punë
3. Të ketë njohuri të thelluara të programit “Alpha”.
4. Të ketë njohuri shumë të mira në përdorimin e programeve të Microsoft-word dhe Excel, Power Point etj.
5. Të njohë të paktën një gjuhë të huaj.
6. Të ketë aftësi komunikuese dhe pune në grup si dhe për të krijuar marrëdhënie pune efektive me stafin e prokurorisë.
7. Të njohë Ligjin “Për Rregullat e Etikës në Administratën Publike”
8. Të njohë ligjin “Për Prokurorinë”.
9. Të njohë Kodin e Punës dhe atë të Proçedurave Administrative.
10. Të njohë rregulloren e brendshme të institucionit
11. Të ruajë sekretin hetimor.

Fusha e njohurive: aftësite dhe cilësite që do të vlerësohen në një testim me shkrim si dhe atë të intervistës për pozicionin specialist/e finance.

1.Njohuritë mbi Ligjin Nr.97/2016 “ Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

2.Njohuritë mbi Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin civil” i ndryshuar

3.Njohuritë mbi Ligjin nr.9936 date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar

4.Njohuritë mbi Ligjin nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin publik”

5.Njohuri mbi udhëzimin nr 285 datë 19.05.2021, “ Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

6.Njohuritë mbi Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar

7.Udhëzim nr.30,datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

8.Njohuritë mbi Ligjin nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

9.Udhëzim nr.9 datë 20.03.2018, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”

10.Udhëzim nr.2, datë 19.01.2022 të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë “Për përdorimin e arkivës elektronike në procesin e ekzekutimit të buxhetit të shtetit nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme”.

-Kandidatët për një pozicion të lire të punës “ Specialist-Finance”duhet të paraqesin kërkesën së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm :

a.Kërkesë për punësim ,(inventar të dokumentacionit)

b .Fotokopje e kartës së identitetit /pashaportë

c.CV (Jetëshkrim) të detajuar së bashku me një foto.

d.Diplomë e shkollës së Lartë në Shkenca Ekonomike, e noterizuar , çertifikate notash e noterizuar

e.Mastër,Shkencor ose Profesional e noterizuar, çertifikatë notash e noterizuar, si dhe çdo diplomë apo dokument tjetër që tregon specializimin në fushën e caktuar.

f.Dëshmi penaliteti.

g.Vertetim nga Gjykata që nuk ndiqet penalisht

h.Vertetim nga Prokuroria që nuk ndiqet penalisht.

i.Vërtetim nga Zyra e Përmbartimit Gjyqësor

j.Fotokopje të librezës së punës ose vërtetim nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të provojë punësimin e mëparshëm ose vërtetim nga qendra e mëparshme e punës, ku të evidentohet pozicioni i punës dhe kohëzgjatja.

k.Vërtetim vendbanimi.

l.Vërtetim mjekësor për gjëndjen shëndetësore

m.Referenca të mundshme nga punëdhënësi të mëparshëm apo eprori direkt i pozicionit të fundit.

nj.Vertetim se nuk ka asnjë mase disiplinore ne fuqi

- Kërkesa së bashku me dokumentacionin e kandidatit, të paraqitet nga dt. 22.10.2024 ora 8.00 deri në datë 06.11.2024 ora 16.00, në K/sekretarinë e Prokurorisë Pranë gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Rr “ Haxhi.H. Dalliu “ Nr 97 Tiranë .

Konkurimi për vendin e punës në pozicionin “ Specialist -Finance” do të zhvillohet në dy faza:

Faza e parë: verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidatet, e cila realizohet nga Kancelari i kësaj Prokurorie me qëllim vlerësimin e dokumentacionit nëse janë plotësuar kriteret e shpallura në njoftim.

Kandidatët të cilët nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e përcaktuara skualifikohen.

Faza e dytë: Testimi (me shkrim, me gojë).

-Kandidatët e kualifikuar i nënshtrohen intervistës së strukturuar me gojë, vlerësimi me shkrim si dhe vlerësimi të jetëshkrimit ku konsiston arsimimi, përvoja e punës, kualifikimet, trajnimet aftësite profesionale .

-Totali i pikëve të vlerësimi është 100 pikë të mundshme të cilat ndahen në këtë kategorizim:

Vlerësimi i jetëshkrimit, eksperiencia e trajnimeve etj, 20 pikë

Vlerësimi i testimit me shkrim, 50 pikë

Vlerësimi për intervisten e strukturuar me gojë, 30 pikë

-Testimi do të bazohet në kërkesat mbi kriteret e veçanta dhe njohuritë mbi ligjet e specifikuar në të.

Që kandidatët të shpallen fitues duhet të marrin mbi 70 pikë.

-Vlerësimi i kandidatëve nga komisioni do të bëhet bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga secili kandidat si dhe rezultati i testimit me shkrim dhe të intervistës me goje me secilin prej tyre.

-Testimi dhe Intervista me secilin kandidat, do të kryhet në ambjentet e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, salla e mbledhjeve kati 6.

- Njoftimi i datës dhe ores së intervistimit për kandidatët e kualifikuar do të bëhet me telefon ose email nga Kancelari.

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM**

TIRANË

